

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtësen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Ilaz Ceka nga fsh.Glloboqice ,komuna e Kaçanikut , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 22.11.2013 merr këtë;

A K T V E N D I M

I pandehuri Ilaz (Hasan) Ceka ,i lindur me dt.23.04.1962 ne fsh.Glloboqice ,komuna e Kaçanikut ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, I martuar prind I tete femijeve, ka te kryer shkollen e mesme, keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Kaçanik ,i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtar i larte publik ne pozitën e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Kaçanik ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me datën 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet) €



